



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Tiranë, më 02/12/2020

nr. 1151 Prot

URDHËR

Nr. 122, Datë 02/12 2020

MBI
“ZHVILLIMIN E ANALIZËS VJETORE TË PUNËS
PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020 NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 32, nenit 38, nenit 39, nenit 49 si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” të MASR,

URDHËROJ:

1. Njësitë kryesore, njësitë bazë, drejtoritë, degët/sectorët në Universitetin e Arteve, të përgatisin dhe të zhvillojnë analizën vjetore të punës, për vitin akademik 2019-2020, **brenda datës. 16. 12. 2020.**
2. Fakultetet e Universitetit të Arteve, materialin e analizës vjetore **mbi veprimtarinë akademike**, ta dorëzojnë në zyrën e protokollit **brenda datës 17.12.2020**, dhe në formë elektronike në adresën e emailit: zvrektor.mes@uart.edu.al.
3. Drejtoritë, degët/sectorët në Universitetin e Arteve, materialin e analizës vjetore të punës, **për veprimtarinë administrative** ta dorëzojnë në zyrën e protokollit, **brenda datës 17.12.2020**, dhe në formë elektronike në adresën e emailit: zvrektor.mes@uart.edu.al.
4. Analiza vjetore e njësisve kryesore, njësisve bazë, drejtorive, degëve/sectorëve në Universitetin e Arteve, të përqendrohet në realizimin e objektivave të planifikuara për vitin akademik 2019-2020, **sipas funksioneve të tyre** të shoqëruara me fakte, shifra, statistika, etj., në zbatim të Udhëzimit Nr. 5, datë 19.02.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” të MASR.





5. Për përgatitjen e Raportit të Analizës Vjetore të Punës për vitin akademik 2019-2020 të Universitetit të Arteve, mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ngrihet grupi i punës si më poshtë:
- Prof. Dr. Erald Bakalli Kryetar
 - Prof. Arian Paço Anëtar
 - Prof. Dr. Isak Shehu Anëtar
 - Prof. Petrit Malaj Anëtar
 - Prof. Artan Peqini Anëtar
 - Alma Sinani Anëtare
 - Nikoleta Lipivani Anëtare
6. Raporti i Analizës Vjetore i Universitetit të Arteve, i përgatitur nga grupi i punës, sipas pikës 5 të këtij urdhri, të dorëzohet në Rektorat **brenda datës 21.12.2020.**
7. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve, në rubrikën “Njoftime” si dhe tu shpërndahet të gjithë instancave dhe strukturave të Universitetit të Arteve.
8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, të gjitha instancat, strukturat si dhe anëtarët e grupit të punës sipas pikës 5 të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Kastriot ÇAUSHI

**REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE**

